UJI

- Preferoni të bëni **dush** se sa banjë. Uji i një banje korrespondon me 3 dusha.



- Mbylleni mirë **kroin** dhe ndërroni gomzatat e kroit po të jetë e nevojshme. Kroi i cili pikon ose kazani i cili rrjedh mund të hargjojnë 3 deri 4 litra ujë në orë.

- Kyqeni **lavatriqen** vetëm atëhere kur është e mbushur dhe përdorini **programet e shkurta me temperaturë të ulët**
(30°për rrobe me ngjyra, 60°për të bardhat).

- Vendoseni një **shishe me ujë** në **kazanin e toaletit** për të zvogëluar sasinë e hargjimit të ujit sa herë që përdorni toaletin.

Tarifat solidare

Tarifa është e aplikuar për të gjithë personat e regjistruar në regjistrin e popullsisë. Nëse nuk është rasti i juaj, ju mund të kërkoni një **vërtetim të vendosjes** në komune.
(Nganjëhere është e domosdoshme të insistoni!)

Distribuesi Ndërkomunal i Ujit në Bruksel
Intercommunale Bruxelloise de Distribution d'Eau *(IBDE)*
Rue aux laines, 70
1000 Bruxelles,
tel. 02/518.81.11

Fletushkat në dispozicion

Ecuritë

1 - Kërkesa e një banese
2 - Vizita dhe instalimi (vendosja)
3 - Kontrata dhe qiraja
4 - Sigurimi kundër zjarrit
5 - Kodi i banimit

Rreziqet

6 - Banesa dhe shëndeti
7 - Pastrimi i oxhakut
8 - Lagështija
9 - Mirëmbajtja dhe riparimet
10 - Rreziku nga CO

Për të jetuar më mirë

11 - Kursimi i ujit dhe energjisë

Kjo fletushkë është në dispozicion në gjuhët në vazhdimësi :

Shqip	Farsi
Anglisht	Frengjisht
Arabisht	Rusisht
Spanjollisht	Turqisht

Adaptimi në bazë të broshurës së realizuar nga ana e CIRE-së dhe Convivence/Samenleven.
Përkthimi : Naim Mucaj, CIRÉ Shërbimi i përkthimeve
Përgaditur : Tetorë 2006
Forma dhe adaptimi : Alix Francart
Vizatimet : Thomas De Coster
Editore përgjegjëse : Frédérique Mawet

Coordination et Initiatives pour et avec les Réfugiés et Étrangers
Rue du Vivier, 80-82 B - 1050 Bruxelles
+322/629.77.10
http://www.cire.be/
cire@cire.irisnet.be

Avec l'appui de la Région de Bruxelles-Capitale

BANESË ME QIRA

Për të jetuar më mirë

FLETUSHKA N°11

KURSIMI I UJIT DHE I ENERGJISË

Shqip

Albanais



Ide e mirë!
Mereni fletushkën e njëjtë edhe në frengjisht, që ti mësoni fjalët (shprehjet).

C.I.R.É.

NGROHJA

- Nxehni mjaft, por jo tepër.
- Mos nxehni tjetër, përveq dhomës ku rrini.

Kur të **ajrosni** banesën **qkyqeni ngohjen**.

- Nëse keni të ftohët, visheni një **gjemper** në vendë që ta shtoni ngohjen.

Kujdes me **aparatet e vogla lëvizëse**. Përdorni sa më pakë të jetë e mundur **ngrohëse elektrike** dhe keni kujdes nga **ngrohëset e rrezikshme** (vajguri ose butan).

- Nëse mundeni, **izolojeni** banesën tuaj.
- Kur ju të **largoheni nga banesa**, **zbriteni** ngrohjen.
- Pastrojeni rregullisht ngrohësin me gaz. Kur ti hiqet pluhuri, funksionon më mirë.



- **Perdet** nuk duhet të mbulojnë ngrohësin (humbje e nxehtësisë dhe rrezik zjarri).
- Gjatë **natës**, mos e zbritni ngrohjen më ulët se 16-17°. Përndryshe, duhet tepër energji në mëngjes për ta ngrohur shtëpinë.
- Evitoni të thani **rrobet e lagura** mbi radiatora (rrezik zjarri mbi një ngrohëse me gaz).



GAZI DHE ELEKTRICITETI

- Fikini **dritat** kur të largoheni nga dhoma ose nga banesa.
- Mundësisht, përdorni **poqet ekonomike** ose **tuba të neonit**.



- **Të zieni në tengjere**, me një **kapak**, hargjon më pak energji se të zieni në furrë.
- Nëse zieni me **rrymë elektrike**, përdorni tengjeren me dimensione të pllakës për të evituar humbjen e energjisë dhe qkyqeni pllakën para se të përfundojë zierja.
- Zieni me pak ujë. Ju konsumoni më pak dhe është më e shëndetshme.
- Një **shporet me gaz** hargjon **2 here më pak energji** se një shporet elektrik.

- **Frigoriferit** dhe **frigoriferit me ngrirje të thellë** duhet **rregullisht tu hiqet akulli**.
  Hargjimi i elektricitetit dyfishohet prej **4 cm akull**.
- **Për të evituar formimin e akullit :**
  1) Mos e lini deren e frigoriferit të hapur pa nevojë.
  2) Lejeni ushqimin të ftohet para se ta vini në frigorifer.
- Pastrojeni **rrjetën metalike prapa frigoriferit** për të evituar nxehjen e tepërt, çka rrit hargjimin e energjisë.
- Fikini **tërësisht** aparatet (TV, video) dhe qkyqni mbushësat (celularit, të baterive).
- Nuk duhet ta lini ngrohësin e ujit ndezur pa nevojë.
- Rregullojeni ngrohësin tuaj të ujit në **45°** (kuzhinë dhe banjo).

- Pastrojeni **ngrohësin e ujit nga gëlqerja** së paku **çdo 2 vite**.
  Gëlqerja rrit kohën e nevojshme për të ngrohur ujin dhe kjo shkakton hargjim më të madh të energjisë elektrike.

Tarifa sociale

Zvogëlimi i tarifës për energji elektrike dhe gaz, për ata që marin të ***ardhura të integrimit social*** ose ***ndihmë sociale financiare*** nga ana e një QPAS (CPAS).
(Azilkërkuesit nuk kanë të drejtë për këtë).
Kërkesës për tarifë sociale duhet ti bashkangjitet një **vërtetim i QPAS** (CPAS).

Për SIBELGA
Chaussée d'Ixelles, 133 – 1050 Bruxelles
Rue des Poissonniers, 13 – 1000 Bruxelles
Square E. Machtens, 17 – 1080 Bruxelles
tel. gjeneral : 02/549.41.00